

L I G J
Nr. 7973, datë 26.7.1995

**PËR KONCESIONET DHE PJESËMARRJEN E SEKTORIT PRIVAT NË
SHËRBIMET PUBLIKE DHE INFRASTRUKTURË**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 8105, datë 28.3.1996; dekretin nr. 1628¹, datë 17.10.1996;
me ligjin nr. 8329², datë 16.4.1998; nr. 8618, datë 14.6.2000; nr. 9053, datë 17.4.2003; nr.
9346, datë 17.2.2005)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi i këtij ligji është: Të krijojë kuadrin ligjor për pjesmarrjen e sektorit privat, vendas e të huaj, nëpërmjet koncesioneve dhe formave të tjera të partneritetit shtet-privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji:

1. “Qeveri” do të thotë Këshilli i Ministrave.
2. “Organ shtetëror i autorizuar” është çdo organ shtetëror administrativ, i cili është caktuar nga Këshilli i Ministrave për të bërë një kontratë koncesioni ose kontratë partneriteti shtet-privat.
3. “Bankë” është Banka e Shqipërisë.
4. “Koncesion” është një formë kontrate e marrëveshjeje, me anën e së cilës një person juridik joshetëror ose fizik i jepet e drejta të marrë në formën e koncesionit nga organi shtetëror i autorizuar një pasuri për të kryer shërbimet e specifikuara për një periudhë të gjatë kohe në një nga format e parashikuara në këtë ligj. Subjekti, të cilit i jepet koncesioni, është përgjegjës për financimin e investimeve të reja të specifikuara gjatë periudhës së koncesionit. Pasuritë e reja të krijuara i kalojnë sektorit shtetëror në përfundim të koncesionit.
5. “Koncesionar” është personi juridik ose fizik, të cilit organi shtetëror i autorizuar i

¹ Dekret nr. 1628, datë 17.10.1996 është miratuar me ligjin nr. 8166, datë 21.11.1996 të Kuvendit Popullor.

² Ligji nr. 8329, datë 16.4.1998 në nenin 2 shprehet;

“Projektet në shërbimet publike apo infrastrukturë, që do të kontraktohen në sektorin privat për sektorët e përcaktuar në pikat 2,3,4,7,8 dhe 9 të nenit 3 miratohen nga Këshilli i Ministrave, ndërsa për sektorët e përcaktuar në pikat 1,5 dhe 6 të nenit 3 miratohen nga pushteti lokal.”

jep koncesionin. Ky person juridik mund të jetë një shoqëri tregtare a bashkime të shoqërive tregtare, ose person fizik vendas apo i huaj.

6. “Projekt” është një program i miratuar nga qeveria për ndërtimin, zgjerimin, rehabilitimin, modernizimin, financimin, shfrytëzimin ose mirëmbajtjen e një shërbimi publik apo të një objekti infrastrukturë, për të cilin qeveria ka autorizuar dhënien e një koncesioni ose krijimin e një partneriteti shtet-privat për një periudhë të përcaktuar kohe, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

7. “BOT” (Ndërtim-Shfrytëzim-Transferim) është një formë koncesioni ku një shoqëri tregtare ose bashkim shoqërie tregtare bie dakord të financojë, ndërtojë, administrojë dhe mirëmbajë një impiant për një periudhë të caktuar kohe dhe pastaj t’ia transferojë këtë organit përkatës shtetëror. Variante të tij janë BOOT (Ndërtim-pronësi-shfrytëzim-transferim) dhe BOO (Ndërtim-pronësi-shfrytëzim). Në një projekt BOO kontrata i lejon shoqërisë tregtare të ndërtojë dhe të shfrytëzojë një impiant, por nuk i kërkon që t’ia transferojë atë qeverisë a ndonjë institucioni tjetër shtetëror. Variante të tjera të BOT janë BOT (Rehabilitim-shfrytëzim-transferim), BTO (Ndërtim-transferim-shfrytëzim) dhe BLT (Ndërtim-qira-transferim).

8. “Kontratë BOT”. Çdo marrëveshje e bërë ndërmjet një investitori dhe një organi shtetëror të autorizuar për zhvillimin dhe zbatimin e një projekti sipas formës së koncesionit BOT.

9. “Kompani BOT” është një kompani me kapital privat, vendas a të huaj, e themeluar sipas ligjeve në fuqi për të zbatuar një kontratë BOT, një koncesion ose një projekt partneriteti shtet-privat.

10. “Kompani koncesionare”. Shiko “Kompani BOT”.

11. “Kontratë koncesioni”. Shiko “Kontratë BOT”.

12. “Korporatizim” është kthim i ndërmarrjeve ose institucioneve shtetërore në shoqëri anonime ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas dispozitave në fuqi.

13. “Aksion i artë” është një aksion i vetëm në një shoqëri tregtare që mbahet nga qeveria. E arta e këtij aksioni lejon qeverinë të vërë veton mbi disa veprime specifike të shoqërisë, si në emetimin e aksioneve shtesë, shitjen e aksioneve shtesë të huajve etj.

14. “Qiramarrje” është një marrëveshje, me anën e së cilës një person juridik privat (qiramarrësi) kontraktin me një organ shtetëror të autorizuar për të fituar të drejtën e shfrytëzimit të një objekti a impianti, si dhe të drejtën për të marrë të ardhurat nga kryerja e një shërbimi të specifikuar për një periudhë të caktuar kohe. Impianti ose objekti vazhdon të jetë pronë shtetërore. Ndryshe nga koncesioni, qiramarrësi nuk është përgjegjës për investime në mjetet kryesore.

15. “Financim i kufizuar” janë kreditë e një projekti, të cilat garantohen plotësisht ose pjesërisht nga të ardhurat që do të krijohen nga projekti dhe jo nga vlera fizike e mjeteve kryesore të projektit, ose kredibiliteti i pronarëve apo i shfrytëzuesve të projektit.

16. “Kontratë administrimi” është një marrëveshje, me anën e së cilës një kontraktues privat merr përgjegjësinë për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen, me të drejtën për të marrë vendime për mënyrën e administrimit. Kompensimi mund të bazohet pjesërisht në shërbimet e kryera (si në kontratat e shërbimeve) dhe pjesërisht në rezultatet e arritura (si në ndarjen e fitimeve).

17. “Projekt i partneritetit shtet-privat” është çdo projekt i zbatuar sipas këtij ligji, me anën e së cilit sektori shtetëror dhe sektori privat ndërmarrin dhe ndajnë përgjegjësi e përfitime të ndryshme në identifikimin, financimin, ndërtimin, shfrytëzimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe rregullimin e punimeve a shërbimeve publike dhe të infrastrukturës, duke përdorur BOO, BOT, qiradhënien, koncesionet, kontratat e administrimit, si dhe variante të tjera të përshtatshme.

18. “Kontratë shërbimi” është një marrëveshje me sektorin privat për kryerjen e një veprimtarie shërbimi për një periudhë të fiksuar kohe dhe për një kompensim të caktuar.

19. “Propozime të kërkuara” janë oferta për të marrë përsipër projekte, për të cilat qeveria ose organi shtetëror i autorizuar i kanë kërkuar sektorit privat të marrë pjesë në një proces tenderi konkurrues, duke përdorur procedurat në fuqi.

20. “Propozime të pakërkuara” janë oferta për të marrë përsipër projekte, për të cilat qeveria ose organi shtetëror i autorizuar nuk i kanë kërkuar sektorit privat të marrë pjesë. Me qëllim që të pranohen për t’u vlerësuar, këto propozime duhet të jenë në përputhje me kriteret e përcaktuara ekonomike, financiare, ambientale dhe teknike.

Neni 3

Fusha e zbatimit të ligjit

(Shtuar pika 7 me dekretin nr. 1628, datë 17.10.1996; shtuar pikat 8 dhe 9 me ligjin nr. 8329, datë 16.4.1998; shfuqizuar pika 4 me ligjin nr. 8618, datë 14.6.2000; shtuar pika 10 me ligjin nr. 9053, datë 17.4.2003; shtuar pika 11 me ligjin nr. 9346, datë 17.2.2005)

Ky ligj mund të zbatohet për dhënien e koncesioneve ose arritjen e marrëveshjeve a kontratave të tjera për shfrytëzimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e pronësisë në sektorët e mëposhtëm:

1. Furnizim me ujë, duke përfshirë prodhimin, administrimin, pastrimin dhe shpërndarjen.

2. Transport, duke përfshirë autostradat dhe rrugët, strukturat inxhinierike, hekurudhat dhe transportin hekurudhor, kanale, porte, aeroporte, ura e tunele.

3. Prodhimi, transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, duke respektuar legjislacionin përkatës.

4. Shfuqizuar.

5. Administrimi, grumbullimi, transportimi, përpunimi dhe eliminimi i mbeturinave të ngurta dhe të dëmshme.

6. Zona industriale dhe parqe, zona të lira dhe zona eksportuese.

7. Furnizimi me gaz natyror, naftë e nënprodukte të saj, duke përfshirë transportin, shpërndarjen dhe stokimin e tyre.

8. Zonat që kanë përparësi turizmin.

9. Sektori minerar.

10. Mjediset sportive.

11. Në shërbime të caktuara në administratën publike, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU II

PROCEDURAT PËR IDENTIFIKIMIN, ANALIZIMIN, MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PROJEKTIT

Neni 4

Llojet e koncesioneve

(Shtuar numërtim në paragrafin e parë me dekretin nr. 1628, datë 17.10.1996; shtuar numërtim në paragrafin e parë me ligjin nr. 9053, datë 17.4.2003; shtuar numërtim në paragrafin e parë me ligjin nr. 9346, datë 17.2.2005)

Projektet në shërbimet publike apo infrastrukturë që do të kontraktohen me sektorin privat për sektorët e përcaktuar në pikat 2, 3, 4, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të nenit 3 miratohen nga Këshilli i Ministrave, ndërsa për sektorët e përcaktuar në pikat 1, 5, dhe 6 të nenit 3 miratohen nga pushteti lokal. Në lidhjen e kontratës do të përdoret një nga metodat e mëposhtme:

1. Koncesionet

- 2.Qiradhëniet
- 3.Kontratat e administrimit
- 4.BOO/BOT/ROT/BLT/BOOT
- 5.Kontratat e shërbimit

Në kuptim të këtij ligji në neniet që vijojnë, me fjalën koncesion do të nënkuptohen edhe metodat e tjera të përmendura më sipër.

Kontrata apo marrëveshja lidhet për një afat deri në 30 vjet.

Neni 5

Detyrat e organit shtetëror të autorizuar

Këshilli i Ministrave cakton organin shtetëror të autorizuar për pregatitjen dhe realizimin e një kontrate koncesioni. Organi shtetëror i autorizuar ka për detyrë:

(a) Të pregatisë programin dhe dokumentacionin e projekteve dhe t'ja paraqesë për miratim Këshillit të Ministrave.

(b) Të përgatisë dokumentacionin dhe specifikimet e tenderit.

(c) Të përcaktojë kushtet dhe metodat e dhënies së koncesioneve.

(d) Të bëjë vlerësimin e ofertave për projekte në përputhje me kriteret përkatëse.

Tenderat shpallen të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë para datës së vlerësimit të ofertave.

Njoftimi për tenderat duhet të publikohet në të paktën dy gazeta kombëtare dhe një gazetë lokale në rajonin ku do të zhvillohet projekti. Në qoftë se është tender ndërkombëtar, ai duhet të publikohet në një numër të mjaftueshëm revistash dhe gazetash të njohura ndërkombëtare për të tërhequr numrin më të madh të ofertave.

Neni 6

Procedurat për propozimet e kërkuara

Me zgjedhjen e ofertës më të mirë, organi i autorizuar nga qeveria, me anën e një letre mirëkuptimi, fton për bisedim fituesin. Letra e mirëkuptimit përmban sigurinë e të dy palëve për angazhim dhe ekskluzivitet paraprak gjatë bisedimeve. Letrat e mirëkuptimit kanë afat deri në 90 ditë, afat që mund të shtyhet në disa raste. Nëse nuk arrihet lidhja e kontratës me fituesin e tenderit, atëherë thirret për bisedime, me të njëjtën procedurë, oferta e dytë më e mirë. Të gjithë konkurruesve të zgjedhur do t'u kërkohej një garanci për ofertën. Para konkurrimit të gjitha projektet pjesëmarrëse do të organizojnë seanca shpjeguese të aspekteve teknik, financiare dhe ekonomike të projektit.

Neni 7

Procedurat për propozimet e pakërkuara

Qeveria ose përkatësisht organi i pushtetit lokal, mund të shqyrtojë propozime për projekte të pakërkuara prej saj në qoftë se ato plotësojnë disa nga kriteret bazë të vlerësimit të ofertave. Këto kritere, të detajuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, përfshijnë:

a) Prioritetin kombëtar-çdo propozim i pakërkuar duhet të jetë një projekt me rëndësi kombëtare dhe të përputhet me qëllimet e zhvillimit kombëtar;

b) Të qenët unik- çdo propozim i pakërkuar duhet të jetë unik dhe origjinal, në kuptimin që nuk duhet të jetë projekt i tenderit konkurrues. Propozimi duhet të ofrojë zgjidhje të reja financiare, ekonomike dhe teknologjike;

c) Kosto të ulët - propozimet e pakërkuara duhet të kenë kosto më të ulët se alternativat e tjera. Kostoja e ulët lidhet me mbështetjen financiare më të pakët nga ana e qeverisë dhe normën më të lartë të fitimit.

Në rast se një propozim i pakërkuar plotëson kriteret e mësipërme dhe merret në konsideratë nga qeveria ose pushteti lokal, ky propozim kthehet në projekt dhe vazhdon procedura si në projektin e kërkuar.

Neni 8

Administrimi i shërbimeve publike

Të gjitha kontratat në sektorë publik jetik duhet të përmbajnë klauzola që sigurojnë kryerjen normale dhe të vazhdueshme të këtyre shërbimeve.

KREU III

MARRËVESHJA E KONCESIONIT

Neni 9

Palët në një marrëveshje koncesioni

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 8105, datë 28.3.1996; shtuar numërtim në pikën 3 me ligjin nr. 8329, datë 16.4.1998)

1. Palët në një marrëveshje koncesioni do të jenë koncesionari (që mund të jetë një person fizik ose juridik, vendas a i huaj, dhe në rastin e personit juridik edhe një kombinim i të dyjave) dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga organi i autorizuar shtetëror. Nuk do të quhet e vlefshme asnjë marrëveshje e bërë nga përfaqësues të një ministrie a institucioni shtetëror që nuk ka përgjegjësi parësore në sektorin ekonomik ku do të operojë kompania.

2. Marrëveshjet mund të kenë disa palë joqeveritare dhe, kur është e nevojshme, më tepër se një dikaster shtetëror si palë kontraktuese.

3. Për pasuritë kombëtare, si ato të përcaktuara në pikat 2, 4, 8 dhe 9 të nenit 3, marrëveshjet hyjnë në fuqi pasi ratifikohen nga Kuvendi Popullor, me përjashtim kur në ligj është parashikuar ndryshe. Në rastet e tjera marrëveshjet hyjnë në fuqi kur miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 10

Struktura e marrëveshjes së koncesionit

A. Të gjitha marrëveshjet do të jenë me shkrim dhe do të përmbajnë dispozitat e mëposhtme. Mund të përfshihen dispozita shtesë, sipas rrethanave specifike të projekteve specifike.

1. Autorizimet e përfaqësuesve të palëve që i lejon ata të nënshkruajnë marrëveshjen.
2. Afati i marrëveshjes.
3. Kushtet dhe afati i ekskluzivitetit kur marrëveshja është ekskluzive.
4. Kriteret specifike të punimeve. Këtu do të përfshihen përshkrime specifike të elementëve të punimeve, të cilat duhet të përfundohen në data të caktuara dhe sanksionet që do të zbatohen në qoftë se këto nuk realizohen.
5. Parashikimet për forca madhore dhe të drejtat e detyrimit e palëve në rastin e një force madhore.
6. Dispozita për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
7. Përkufizimet për “shkelje materiale” të marrëveshjes së koncesionit dhe sanksionet shtesë për moszbatimin e detyrimeve që do të përcaktohen në kontratë dhe të atyre që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji.
8. Dispozita për transferimin e teknologjisë.

9. Çështje që kanë të bëjnë me projektimin dhe zbatimin e punimeve.
10. Procedurat për paraqitjen dhe kontrollin e projekt-ideve.
11. Përshkrimi i detyrimeve të koncesionarit për zbatimin në afat të projektit sipas projekteve të miratuara.
12. Përshkrimi i të drejtave të koncesionarit.
13. Përshkrimi i çmimeve, tarifave profesionale dhe tarifave të tjera të aplikueshme për zbatimin e projektit.
14. Dispozita që detyrojnë koncesionarin të sigurojë funksionimin normal të projektit.
15. Dispozita që kanë të bëjnë me inspektimin e vizatimeve, pajisjeve, zbatimit dhe përfundimit të projektit, duke përfshirë shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e tij eventual te shteti.
16. Përshkrim i shpërndarjes së riskut të projektit ndërmjet qeverisë dhe koncesionarit.
17. Masat që do të merren në rast përfundimi të projektit ose mosrespektimit të kontratës nga koncesionari.
18. Dispozita që kanë të bëjnë me kalimin e mundshëm të të drejtave të kontratës.
19. Leje e autorizime nga dikasteret përkatëse si vlerësim për ndikim ekologjik, leje për punësimin e të huajve, për përdorimin e tokës si dhe dokumenta të tjera të kërkuara në dispozita ligjore.

Neni 11

Detyrimet e koncesionarit

1. Koncesionari është i detyruar të zbatojë marrëveshjen sipas kushteve të saj.
2. Kompania koncesionare, brenda 30(tridhjetë) ditësh nga nënshkrimi i një kontrate koncesioni, do të formojë një shoqëri koncesionare dhe do të bëjë regjistrimet e nevojshme për të lejuar shoqërinë të zhvillojë veprimtari në Shqipëri. Kompania do të jetë një shoqëri tregtare dhe do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare.
3. Koncesionari është i detyruar të financojë ose të sigurojë financimin e projektit dhe qeveria nuk ka asnjë detyrim financiar, veç atyre të shprehura në mënyrë specifike në marrëveshje ose stimujve dhe mbështetjeve që ajo mund t'i garantojë projektit sipas nenit 14.
4. Kur është e nevojshme dhe me miratim të organit të autorizuar shtetëror, shoqëria koncesionare mund të hipotekojë si garanci pasuritë e shoqërisë me kusht që pasuritë e hipotekuara të vazhdojnë të shfrytëzohen për të përmbushur objektivat e kontratës së koncesionit.
5. Tarifat, pagesat profesionale dhe të ardhurat e tjera të nxjerra nga kontratat e koncesionit duhet të tregohen në mënyrë të qartë në kontratë. Palët kontraktuese duhet të bien dakord për çdo rritje ose ulje të këtyre tarifave, pagesave apo të ardhurave.
6. Koncesionari është i detyruar të respektojë të gjitha ligjet në fuqi.

Neni 12

Të drejtat e koncesionarit

1. Ekskluziviteti. Koncesionari ka të drejtë ekskluzive të kryejë veprimtari në sektorin e koncesionit. Kushtet e ekskluzivitetit i përmban marrëveshja.
2. Të drejta të tjera. Të gjitha të drejtat dhe privilegjet e tjera të koncesionarit, duke përfshirë edhe ato të përmendura në nenin 8, do të negociohen nga koncesionari me organin e autorizuar shtetëror dhe do të përfshihen në marrëveshje.

Neni 13

Të drejtat e organit të autorizuar shtetëror

1. Kontrolli. Organi i autorizuar shtetëror do të ruajë të gjitha të drejtat kontrolluese mbi koncesinin.

2. Ruajtja e pronësisë mbi mjetet kryesore. Organi i autorizuar shtetëror do të ruajë ligjërisht pronësinë mbi mjetet kryesore të koncesionit.

3. E drejta e ndërhyrjes. Kur koncesionari bën një shkelje të rëndë dhe me pasoja të marrëveshjes apo ecuria në punë e koncesionarit nuk mund të vazhdojë sipas mënyrës së kontraktuar, organi i autorizuar shtetëror ka të drejtë të marrë përkohësisht përsipër projektin, deri në zgjidhjen e konfliktit.

4. Aksioni i artë. Kur e lejon marrëveshja, organi i autorizuar shtetëror do të mbajë një aksion apo interes tjetër në projektet që e lejon atë të vërë veton kundër veprimeve të caktuara të koncesionarit që kanë të bëjnë me administrimin e koncesionit. Aksioni apo interesi nuk i jep të drejtë organit të autorizuar shtetëror të votojë në çështje që kanë të bëjnë me punën e përditshme të koncesionit.

Neni 14

Format e mbështetjes së veçantë nga qeveria dhe garantimi i investimeve

A. Për të garantuar qëndrueshmërinë e projektit, Qeveria mund të vendosë, sipas rastit, dhënien e të gjitha ose disa prej stimuljeve apo garancive të mëposhtme:

1. Përfshirjen nga taksa mbi fitimin për një periudhë kohe me miratimin nga parlamenti.

2. Përfshirjen nga tarifat doganore, taksat e qarkullimit ose taksat e importit me miratimin nga parlamenti.

3. Sigurimin e pasurive a shërbimeve të tilla si toka, pajisjet, lënda djegëse, transport urban për punonjësit, mbledhje e mbeturinave.

4. Mbrojtjen nga ndërprerja e kontratës për shkak të një force madhore.

5. Mbrojtje nga ndryshimi i taksave ose tarifave doganore.

6. Indeksimin e çmimit në bazë të një indeksi të caktuar, si për shembull indeksi i çmimit të mallrave të konsumit.

7. Garantimin e konvertimit të monedhës vendase në valutë, kur është e nevojshme edhe me garanci bankare.

8. Garantimin ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit të valutës.

9. Garantimin e bashkëpunimit me organet e duhura shtetërore.

10. Garantimin e transferimit të fitimit.

11. Garantimin e një niveli të caktuar kërkesë tregu për mallrat ose shërbimet e projektit.

12. Reduktimi i taksave me miratim nga parlamenti.

KREU IV

ZBATIMI, KONTROLLI I PROJEKTIT DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 15

Zbatimi i projektit

1. Koncesionari do të zbatojë projektin sipas kushteve të marrëveshjes.

2. Koncesionari dhe organi i autorizuar shtetëror do të komunikojë vazhdimisht dhe rregullisht për të siguruar mbrojtjen e interesit publik.

Neni 16
Kontrolli i projektit

1. Organi i autorizuar shtetëtor ka të drejtë dhe detyrë të kontrollojë rregullisht ecurinë e marrëveshjes sipas kushteve të miratuara në të.

2. Koncesionari dhe organi i autorizuar shtetëror duhet të gjejnë mënyrën e përshtatshme të kontrollit, duke qenë dakord që veprimtaritë kontrolluese të organit të autorizuar shtetëror nuk do të përbëjnë ndërhyrje të paarsyeshme në zbatimin e projektit.

Neni 17
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Nëse mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet palëve, atëherë ato do të zgjidhen në organet gjyqësore të Republikës së Shqipërisë, ose nga një arbitrazh, për të cilin palët kanë rënë dakord në marrëveshje a kontratë.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 1192, datë 11.8.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**